

Permbledhje Teknike mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis

Per Objektivin : "SPITALI RAJONAL FIER"

Adresa: Lagja "1 Maj"Rr:Invalidet e Luftes,Fier



Punoi: "Silva STUDIO" SH.P.K.

Përfaqësuar: ing. Silva MEÇAJ

Tiranë, Dhjetor 2015

Lënda: Përshkrimi teknik i Objektivit dhe zhvillimit te aktivitetit te : "Spitalit Rajonal Fier".

Qëllimi i hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është të identifikojë pasojat e mundshme negative dhe pozitive mjedisore që mund të shfaqen gjatë zhvillimit të aktivitetit te " **Spitalit Rajonal Fier**", si dhe të përcaktojë e rekomandojë masat tekniko-organizative për zbutjen e faktorëve negativë, nëse ekzistojnë dhe të atyre që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.

Gjate vleresimit do te trajtohen te gjithe komponentet e ndikimit te aktivitetit spitalor ne mjedisin natyror , shendetsor dhe social te zones.

Ky vlerësim tenton të ndihmojë sa më shumë të jetë e mundur vendim-marrësit me anë të dhënies së informacioneve të mjaftueshme mjedisore, çka kontribuon edhe për lehtësimin e ndjekjes dhe monitorimit të aktivitetit të mësipërm nga subjektet përkatëse. Ky studim përfshin një përshkrim të zonës dhe objekteve zhvilluese, përshkon mjediset rrethuese dhe nën ekosistemin të cilit i përket. Ai identifikon ndikimet me të rëndësishme negative e pozitive, jep masat zbutëse dhe ato kompesuese mjedisore.

1.PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

1.1 Pozicionimi i Zonës së Studiuar

Spitali Rajonal i Fierit ndodhet ne Lagjen "1 Maj" Rr:Invalidet e Luftes,Fier

Spitali pozicionohet në lindje të qendres se qytetit të Fierit ne nje largesi prej rreth 230.0 m nga sheshi perpara Bashkise Fier

Ai pozicionohet buze rruges dytesore "Jani Minga " ne krahun lindor ne akses te drejtperdrejte me te.

Spitali i Fierit ndodhet ne anen jugore te rruges kryesore ne nje largesi prej rreth 170.0 m .

Nga informacioni i disponuar , zona ku ndodhet Spitali nuk eshte e perfshire ne menyre te drejteperdrejte ne " Zona te mbrojtura me ligj " si: park kombetare, zone ujore e mbrojtur, zone me ndertime me vlere dhe zone monumentale, te cilat ruhen ne perputhje me planet e zhvillimit ekonomik te vendit.

Zona ku ndodhet Spitali eshte nje zone urbane e pozicionuar prane qendres se qytetit.

1.2 Profili i Subjektit

Subjekti **SPITALI RAJONAL Fier** eshte institucion shteteror buxhetor, ne varesi te **Ministrise se Shendetesise**, jo fitim prures, person juridik publik.

Infrastruktura spitalore dhe inxhinierike e godinave spitalore eshte :

1-Poliklinik Qendrore te Specialiteteve ku kryhen vizitat ambulatorore,

2-Godina e Maternitetit eshte e perber nga 3 sherbime Pavioni i Obsetrikes,Gjinekologjise,Neonatologjise+RNM.

3-Sherbimi i Pediatrise eshte i ndare ne Pediatri Somatike,RNM Pediatri,Pediatria Infektive.

4-Godina e Spitalit ofrone shëbimin e Pranim-Urgjences,Kirurgjise,Patologjise,RNM Patologji,RNM Kirurgji,Infektivit te Rriturve,ORL+Okulistik.

1.3 Qellimi i zhvillimit te aktivitetit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte ofrimi i sherbimeve spitalore per te permiresuar shendetin duke ju gjendur sa me prane per te gjithë popullsine ne rajonin e Fierit dhe jo vetem. Sherbimi shendetesor i ofrohet gjithë komunitetit me mjeket specialist te ketij spitali.

Vizioni I ketij spitali eshte rritja e besueshmerise se komunitetit, permiresimi i sherbimit shendetesor si dhe zhvillimi,vleresimi dhe perdorimi i teknikave te reja nga nje staf me vlera te larta mjekesore dhe shkencore.

Spitali Rajonal Fier është një nga spitalet rajonale më të mëdha me nje kapacitet prej 429 shtretërish. Spitali ynë ofron kujdesin mjekësor në Poliklinikën e Specialiteteve, Shërbimin e Pranim – Urgjencës, Laboratorin Klinik – Biokimik dhe Baktereologjik si edhe shërbimin me shtretër ne specialitetet e tij. Shërbimi i Kirurgjisë në Spitalin Rajonal Fier ka statusin e Klinikës Universitare. Ky spital ka një staf prej 87 mjekësh dhe Infermier + laborant dhe fizioterapist –285. Duke i dhënë rëndësi të veçantë edukimit në vazhdim personeli ndjek rregullisht aktivitetet mjekësore kombëtare dhe ndërkombetare. Në spitalin rajonal të Fierit ka në shërbim te pacientëve staf të kualifikuar me ne total 527 punonjes.

Objektivat e zhvillimit te aktivitetit

- 1- Kujdesi shëndetësor cilësor me akses të plotë
- 2- Përmirësimi i infrastrukturës spitalore dhe kushteve të punës
- 3- Zbatimi dhe unifikimi i protokolleve të mjekimit.
- 4- Zbatimi i kodit të etikës dhe deontologjisë
- 5- Ngritja e vazhdueshme profesionale e personelit mjekësor
- 6- Zgjerimi dhe rritja e gamës së shërbimeve në spital
- 7- Përcaktimi i standarteve profesionale për të gjithë personelin
- 8- Edukimi i pacientit

Sherbimet spitalore qe ofrohen jane :

- Shërbimi i kirurgjisë se pergjithshme
- Sherbimi ORL – Okulistike
- Shërbimi i patologjisë
- Shërbimi i Anestezi – Renimacionit
- Shërbim i Infektivit
- Sherbimi I Gjinekologjise
- Sherbimi i Pediatrie
- Sherbimi i Urgjence – Pranimit
- Sherbimi i +Neonatologjise
- Sherbimi i Poliklinikes

Spitali ka 527 punonjes te ndare si me poshte

Nr. Mjek –87

Nr . Infermier + laborant dhe fizioterapist –285

Nr. Sanitare – 88

Nr. Administrata –29

Nr. Prapavije –38 dhe

është i organizuar në 429 shtretër të cilët ndahen si më poshtë:

Pedriatria – 101

Kirurgjia e pergjithshme - 45 shtretër

Patologjia 65 shtretër

Infektivi – 32 shtretër

Orl – Okulistika 20 shtretër

Materniteti 100 shtretër

Reanimacion i kirurgjise– 7 shtretër


Pranim-Urgjenca 12 shtreter



Neonatologjia 47 shtreter

Gjate viteve te zhvillimit te aktivitetit si dhe ne vitet ne vazhdim te funksionimit te spitalit, ky aktivitet do te jete konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

Ky vleresim i ndikimit ne mjedis do te paraqes nje informacion te shkurter te aktivitetit ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe investitori do te marr per zbatimin e kriterëve te nevojshme per mbrojtjen dhe menaxhimin sa me racional te mjedisit.

Planvendosja e Spitalit Rajonal Fier





1.3 MENAXHIMI I MBETJEVE QE DO GJENEROHEN

Mbetjet e gjeneruara nga SRF jane ta karakterit spitalor dhe urban. Mbetjet spitalore te cilat konsiderohen edhe mbetje te rrezikshme si nga pikpamja hjgjenosantare ashtu edhe nga ajo mjedisore i kushtohet nje vemendje e vecante, e cila kalon ne disa faza.

Faza e pare e procesit eshte mbledhja e diferencuar e mbeijeve spitalore ne kontainer specifik per tu dalluar nga kontenieret e tjere per mbetjet urbane. Mbetjet spitalore ndahen ne:

- mbetjet e mprehta te cilat vendosenne kontenitore plastike nje perdorimesh.
- mbetjet e kontaminuara me materiale biologjike ,kryesisht shiringat, seti i perfuzioneve transfuzioneve, pambuket, garzat etj hidhen ne kontenitoret e paisur me qeset perkatese.
- mbetjet e tjera spitalore jo te rrezikshme vendosen ne kosha te pajisur me qese te zeza.

Spitalit Rajonal Fier gjeneron disa lloje te mbetjeve te rrezikshme spitalore si:

- Mbetje spitalore plastike, metalike, garza, pambuke te kontaminuar me gjak dhe produktet e tij.
- Mbetje Anatomo - Patologjike
- Placenta dhe fetuse humane
- Medikamente te skaduara .
- Helme farmaceutike
- Kimikate dhe reagente te laboratorit te dala jashte perdorimit.

1. **Mbetjet Spitalore asgjesohen nepermjet operatoit ekonomik qe eshte kontraktuar nga Spitali Fier operatori MEDI-TEL sh.p.k.**
2. Mesatarisht prodhohen 600kg Ne jave mbetje spitalor te rrezikshme. Mesatarisht 2400kg ne muaj.

Keto mbetje paraqesin vazhdimisht rrezikshmerine per ndotje te ambientit ne zonat perreth dhe me gjere. Keto mbetje paraqesin vazhdimisht rrezikshmerine per ndotje te ambientit ne zonat perreth dhe me gjere.

Mbetjet gjenerohen ne klinika dhe sherbime. Depozitohen ne kontenitoret perkates dhe ne oraret e percaktuara dergohen ne vendin kryesor te ruajtjes qe terhiqen nga operatori ekonomik MEDI-TEL

Ne Spitalin Fier funksionojne 3 kaldaja 1kaldaj te Materniteti, 1kaldaj te Godina Qendrore e Spitalit, 1kaldaj te godina e Pediatri+Administrate. Kaldajat punojne 8 ore ne dite nga ora 04:00-07:00 dhe 18:00-23:00. Kapciteti kaldaj e Pediatri 5000 litra, kaldaja e Spitalit 3500lt, kaldaj e Maternitetit 8000 litra.

Ky Raport Mjedisor u përgatit nga:

Studio "Silva STUDIO" sh.p.k.

E licencuar

Nga MINISTERIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE

Me Vendimi Nr. 6, Nr. Regj 243 datë 31.05.2007

SILVA STUDIO shpk.

E përfaqësuar nga :

Ing. Silva Meçaj

Tiranë, Dhjetor 2015